

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Saida Dollani, gjyqtarja që guxoi të vendosë një standard drejtësie
ADRESA	https://kohajone.com/aktualitet/saida-dollani-gjyqtarja-qe-guxoi-te-vendose-nje-standard-drejtësie/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 16:09:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 16:08:20 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e611b1c9e5c1a86db01ad4f1486b99d4a343373e07791e291b49f4e657c8e43b
TEKSTI	145cba4b89e510bd05c870e368e075301959bea29e51ef3e283c58d876c5ae78
PAMJA	d39620c5fce14b1b4458493a11a60dbd48bd057edd10eb09fda3490efb075d64

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d96b83bd302aa6aa34ed59812db382c3597a252a4418a01b5815bae02862bc11
E MËPARSHMJA	93f415fe87280eb4f4932f93b4ff35b32442e950dfa2f358dc94e1e3ddcb3f86
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d96b83bd302aa6aa34ed59812db382c3597a252a4418a01b5815bae02862bc11>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Saida Dollani, gjyqtarja që guxoi të vendosë një standard drejtësie

AKTUALITET | KRYESORE | E HËNË, 14 SHTATOR 2026 18:08



Vendimi i gjyqtarës së Apelit të Posaçëm, Saida Dollani, për të nxjerrë ish-presidentin Ilir Meta nga kafazi i xhamtë dhe për ta ulur pranë avokatit të tij, duhet përshëndetur si një akt kuraje profesionale dhe qytetare.

Në pamje të parë, mund të duket si një vendim i zakonshëm procedural. Në të vërtetë, ai vendos një standard të rëndësishëm për mënyrën se si duhet të trajtohet çdo person që përballlet me drejtësinë. Ilir Meta nuk u shpall i pafajshëm dhe as u lirua nga paraburgimi. Për akuzat ndaj tij do të vendosë gjykata, mbështetur mbi provat dhe ligjin. Por, deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë, ai gëzon prezumimin e pafajësisë. Ky është një parim themelor i drejtësisë dhe jo një favor që gjykata ia bën një të pandehuri.

Gjyqtarja Saida Dollani pati kurajën të thoshte se dinjiteti njerëzor dhe e drejta për një mbrojtje efektive duhet të respektohen edhe brenda sallave të drejtësisë së posaçme. Vendosija e një të pandehuri në një kafaz të mbyllur prej xhami krijon, që në fillim, pamjen e një njeriu të dënuar. Për më tepër, ajo mund ta vështirësojë komunikimin normal dhe konfidencial ndërmjet tij dhe avokatit. Në një proces të drejtë, i pandehuri duhet të jetë në gjendje të këshillohet me mbrojtësin e vet. Ai nuk mund të mbahet i izoluar vetëm për efekt të një praktike të trashëguar apo të një perceptimi

LAJMET KRYESORE



Saida Dollani, gjyqtarja që guxoi të vendosë një standard drejtësie



Mos i përdorni fëmijët e shkollave për mitingje dhe luftë politike!



Trump kundërshton rregullimin e AI, sulmon CEO-n e Anthropic, Dario Amodei



OKB bën thirrje për 'veprim urgjent' për të frenuar AI përballë 'rreziqeve të paprecedenta'



Zv/kryeministria Koçi për alarmin e rremë në shkollë: Çmenduri e mirëfilltë kriminale


TË PËRZGJEDHURA



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve



Dëshirat e Spallettit dhe blerjet e Juventus-it



Tesla, drejtimi gjysmë-autonom drejt përshtatjes me rregullat evropiane, thotë Franca



Shpërthen Erion Braçe te Nikoll Lesi në KOHA JONË-DEBAT: Nuk votoj kandidat me "njoftim"!

MË TË LEXUARAT

publik.

Saida Dollani nuk u fsheh pas rutinës. Ajo iu referua standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe mori përgjegjësinë që i takon një gjyqtari të pavarur. Pikërisht këtu qëndron rëndësia e vendimit të saj. Në Shqipëri, ku shpesh arrestimi paraqitet si dënim dhe akuza si fajësi e provuar, duhen gjyqtarë që t'i rikthejnë procesit ekuilibrin ligjor.

Drejtësia nuk tregon forcë duke poshtëruar një të pandehur. Ajo tregon forcë kur respekton të drejtat e tij, edhe kur emri përballë saj është politikisht i rëndësishëm apo publikisht i paragjykuar. Ky vendim nuk duhet lexuar si një qëndrim në favor të Ilir Metës si politikan. Ai është një vendim në favor të shtetit të së drejtës. Sot përfituesi i këtij standardi është një ish-president i Republikës. Nesër mund të jetë një qytetar i zakonshëm, i cili nuk ka pushtet, mbështetje politike apo mundësi për ta ngritur publikisht zërin.

Për këtë arsye, kurajoja e gjyqtarës Dollani meriton të vlerësohet. Ajo tregoi se gjyqtari nuk duhet të marrë vendime për të kënaqur turmat, politikën apo atmosferën e ditës. Një gjyqtar duhet t'i bindet vetëm Kushtetutës, ligjit dhe ndërgjegjes së tij profesionale. Saida Dollani vendosi e para një standard që duhet të ndiqet edhe nga trupat e tjera gjyktuese. Të pandehurit nuk mund të ndahen në kategori sipas emrit, pozitës apo akuzave që rëndojnë mbi ta.

Nëse nuk ekziston një rrezik konkret për sigurinë, kafazi i xhamtë nuk duhet të përdoret si një skenografi poshtërimi dhe paragjykimi.

SPAK dhe GJKKO kanë një mision të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Por pikërisht për shkak të fuqisë së madhe që kanë, ato duhet të jenë edhe më të kujdesshme në respektimin e të drejtave themelore. Drejtësia e re nuk mund të fitojë besimin e qytetarëve vetëm me arrestime. Besimi fitohet edhe duke garantuar procese të drejta, dinjitet njerëzor dhe barazi përpara ligjit. Vendimi i Saida Dollanit është një sinjal se brenda sistemit ka gjyqtarë që nuk kanë frikë të arsyetojnë, të marrin përgjegjësi dhe të ndryshojnë praktika të diskutueshme.

Shqipëria ka nevojë për gjyqtarë të tillë. Gjyqtarë që nuk ndikohen nga emri i të pandehurit dhe as nga zhurma politike që e rrethon procesin. Gjyqtarë që e dinë se mbrojtja e të drejtave të një të akuzuari nuk e dobëson drejtësinë, por e bën atë më të fortë.

Saida Dollani dha një shembull që duhet të shndërrohet në standard dhe jo të mbetet një përjashtim. Ajo dëshmoi se drejtësia mund të jetë e vendosur pa qenë poshtëruese, e fortë pa qenë çnjerëzore dhe e pavarur pa iu nënshtruar presionit të askujt. Në të vertetë gjyqtarë si Dollani duhet të ketë sa me shumë drejtësi, sepse tregojnë personalitet, profesionalizëm dhe kurajo për të thyer disa rregulla strikte të vjetra.

Për këtë vendim, gjyqtarja Saida Dollani meriton respekt dhe përgëzim publik. Sepse, në fund, drejtësia nuk mbrohet vetëm kur dënon fajtorët. Ajo mbrohet edhe kur garanton dinjitetin dhe të drejtat e atyre që ende nuk janë shpallur fajtorë.

MË SHUMË NGA AKTUALITETI



Mazhoranca kërkon rritjen e pagave të gjyqtarëve, Bylykbashi: Brenda ...

SHBA-Shqipëri, trajnim për misionet e evakuimit mjekësor me helikopte...

Zv/kryeministrja Koçiu për alarmin e rremë në shkollë: Çmenduri e mir...



FOTO/ Nënkolonel Bedri Kaloshi merr drejtimin e Bazës Ajrore Farkë



Kategoria e Parë, publikohet formacioni më i mirë i javës së 2-të



Tranjeri i kuqezinjëve, Maran: Ndiheh si në shtëpi, shqiptarët kanë n...

LAJMET E FUNDIT



Prefekti i Tiranës, Shkëlqim Hajdari uron nisjen e vitit të ri shkollor: E ardhmja e Shqipërisë fillon në bankat tuaja

[9 MINUTA MË PARË](#)



16 shtatori, ambasada e Amerikës thirrje qytetarëve: Mos shkoni në punë, as shkolla

[16 MINUTA MË PARË](#)


Mazhoranca kërkon rritjen e pagave të gjyqtarëve, Bylykbashi: Brenda kufijve kushtetues

[22 MINUTA MË PARË](#)



Konfirmohet tërheqja e Neymarit nga Brazili

[31 MINUTA MË PARË](#)



Saida Dollani, gjyqtarja që guxoi të vendosë një standard drejtësie

[32 MINUTA MË PARË](#)

SHBA-Shqipëri, trajnim për misionet e evakuimit mjekësor me helikopterët "Black Hawk"

[37 MINUTA MË PARË](#)

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: **Nikoll LESI**. Adresa e redaksisë: Rruga "Sami Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA



© 2024 KOHA JONË. All rights reserved.

[PRIVACY POLICY](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.